VENDIM
Nr.755, datë 9.11.2006

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË UNESCO-S "RESTAURIMI I QENDRËS HISTORIKE TË GJIROKASTRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri "Investime", artikulli "231", t'i shtohet fondi prej 120 000 000 (njëqind e njëzet milionë) lekësh për financimin e projektit të UNESCO-s "Restaurimi i qendrës historike të qytetit të Gjirokastrës".

2. Transferimi i fondit për llogari të UNESCO-s do të bëhet pas miratimit të marrëveshjes, ndërmjet kësaj organizate ndërkombëtare dhe Këshillit të Ministrave.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha